

## **Broshurë informative për prindërit shqiptar**

### Informationsbroschüre für albanisch sprechende Eltern

#### **Ritet fëmija juaj shume gjuhësh?**

Shumica e njerëzve të kësaj bote rritet dy apo më shumë gjuhësh! Mësimi i dy gjuhëve është një fitim për fëmijën tuaj. Në përgjithësi fëmijët e përballojnë këtë ngarkesë pa probleme të mëdha.

#### **Çfar është shumë gjuhësia?**

Ka disa mundësira për tu ritur shumë gjuhës. Shëmbuj:

- Baba polak flet me fëmijën polonisht, nëna gjermane gjermanisht.
- Një familje spanjolle në gjermani flet në shtëpi spanjisht.
- Një baba suedez fletë me fëmijën e tijë suedisht, nëna angleze anglisht, në kopësht mësonë fëmija gjermanisht.

#### **Ka veçantira zhvillimi shumëgjuhësh?**

Fëmijët mësojnë shprehjen, fjalorin dhe gramatikën e gjuhëve të ndryshme. Vetëkuprohet, ata nuk i flasin të dyja gjuhët njëllor mirë. Shëmbull:

- Një fëmijë turk mundet ti shpjegojë lodrat e kopështit mirë në gjuhën gjermane. Në anën tjetër, ai mundet të tregojë rreth një feste familjare më mirë në gjuhën turke.

Shumëgjuhësia është një ngarkesë e veçantë për çdo fëmijë. Gjithësesi duhet të mësohen dy sisteme gjuhësh. Këtu futet shprehja, pasuria e fjalëve, gramatika dhe ndërtimi i fjalisë në kuptimin dhe përdorimin e gjuhës. Përveç kësaj fëmija duhet të respektojë veçantitë kulturore të gjuhës si dhe ato në përdorimin në jetën e përditëshme.

Ka të ngjarë , që fëmija që rritet me dy gjuhë

- të fillojë të flasi me vonesë
- të flasi një herë njëerën gjuhë, pastaj gjuhën tjetër
- ti përdori të dyja gjuhët që në fillim.

Disa fëmijë i përziejnë gjuhët, kjo do të thotë që ata përdorin fjalët e njëerës gjuhë, kur ato mungojnë në gjuhën tjetër. Veçanti të tilla janë të pranishme, në mënyrë të kuptueshme, për një kohë të gjatë. Problemet e qarta dhe të qëndrueshme në të dyja gjuhët duhet të vlerësohen mirë dhe duhet të analizohen.

#### **4. Çfar është normal dhe çfar është pët tu shqetësuar në zhvillimin e të folurit të fëmijës sim?**

*Masë e përgjithëshme për zhvillimin normal të të folurit te shumë gjuhësia është:*

- Në ditëlindjen e dytë fëmija fletë afërsisht 50 fjalë. Te fëmijët që rriten me dy gjuhë mundet të shtyhet kjo kohë rreth gjysëm viti më pas.
- Në ditëlindjen e tretë munden fëmijët të flasin me fjali të përbëra me tre fjalë në njëerën gjuhë.
- Një fëmijë katër vjeçar mundet të kuptohet me persona të jashtëm të familjes së tijë.
- Në rastë se fëmija e dëgjonë dhe e fletë gjuhën gjermane rregullisht (në grupin e lojës, në kopësht, në shkollë...), ai mundet afërsisht pas një viti të shprehet mirë gjermanisht.

*Shënjat për një të folur jo pa probleme te fëmija juaj :*

- fëmija juaj nuk tregon interes të flasi
- mënjanonë të folur në kohë të gjatë
- nuk ka dëshirë ti lexosh libra
- bënë pak ose aspak pyetje
- keqëkuptimet i sqaronë rrallë ose fare. I përzien gjuhët, pa marrë parasysh se cilën gjuhë kuptonë personi që dëgjon
- mësonë gjuhën shumë me vonë

*Përmbledhur.*

Zhvillohet të folurit e fëmijës suaj në mënyrë të qartë ndryshe ose ka të dhëna për një zhvillim të të folurit jo të mjaftueshëm, atëherë ju duhet që ta kontrolloni saktësisht aftësinë e fëmijës për të folur.

### **5. Shkaqet e mundëshme për çregullimet.**

Jo gjithmonë egzistonë një arsye e qartë për çregullimet në zhvillimin e të folurit. Shpesh luajnë disa arsye së bashku një rol Shkaqet më të shpeshta janë.

- **Probleme me të dëgjuarit:** shumë fëmijë kanë probleme për kohë të gjatë me të dëgjuarit ose atë që dëgjojnë nuk mundën ta përpunojnë mirë. Shënja të mundëshme për këtë mundën p.sh të jenë të ftohurit e shpeshtë ose infeksionet e veshit.
- **Çrregullimet në zhvillimin e të folurit:** Ka fëmijë që kanë vështirësi në të mësuarin e të folurit në mënyrë të veçantë, në krahasim me fëmijët e tjerë. Problemet janë të dukshme, si në gjuhën e nënës ashtu edhe në gjuhën tjetër.

### **Trajtimi i drejtë i shumëgjuhësisë.**

Ritet fëmija juaj me dy gjuhë: Me këtë i ofroni ju fëmijës suaj shanse të veçanta!

- Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën e nënës.
- Krijoni te fëmija juaj dëshirën për të folur dhe lëreni fëmijën të tregojë.
- Dëgjojeni fëmijën tuaj me vëmëndje.
- Shtyjeni fëmijën tuaj për të folur dhe pyeteni atë.
- Në rastë se fëmija bënë një gabim, mos e korigjoni atë, por përsëriteni fjalinë të saktë p.sh. “ atje u-Bahni” “ po, atje po vjenë U-Bahni”.
- Folni në veprimet e përditëshme p.sh. kur shtroni tavolinën për të ngrënë, kur e vishni fëmijën, kur shkoni për të blerë, kur luani ose kur shikoni libra me figura.
- Mos haroni: Shikimi i televizorit nuk e ndihmonë fëmijën të mësojë të flasi.
- Mundohuni dhe vetë ti ndani gjuhët: P.sh. sejcili prind fletë me fëmijën në gjuhën e nënës ose ata flasin në shtëpi në gjuhën e tyre, në kopësht fëmija fletë gjermanisht.

### **Në rastë se keni pyetje mundeni të drejtoheni si më poshtë**

- Mjeku i shtëpisë ose i fëmijëve
- Mjeku i veshëve dhe i grykës ( otorinolaringologu)
- Vendi i këshillimit pedagogjik
- Vendi i ndihmës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve
- Pikat e këshillimit për edukimin e fëmijëve.
- Qëndrat speciale ndihëse pedagogjike

**Übersetzung aus dem Deutschen von Kozeta Kapaj, Dolmetscherin für Albanisch**